



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-  
Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government

REPUBLIKA E KOSOVES  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Prilajeno:	23-04-2020	
Njësia Jedinica	Nmri Broj	Shtojca Dodatak
1-400-	16999	



Kuvendi Komunal  
Lipjan

*Ministria e Arsimit e Shkencës e  
Teknologjisë dhe Inovacionit /  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke,  
Tehnologije i Inovacije / Ministry  
of Education, Science, Technology  
and Innovation*

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), lidhë:

**MARRËVESHJE PËR GRANT SHKOLLOR**  
Nr. 57260 ESIP /SDG/

Prishtinë, datë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Fondi burimor për Grante:** Marrëveshja për Grante zhvillimore nga IDA nr: P149005, e nënshkruar më 20 Nëntor 2015, në mes Republikës së Kosovës dhe Bankës botërore IDA (Asociacioni për Zhvillim Ndërkombëtar) për Projektin për përmirësimin e sistemit të arsimit në Kosovë (ESIP)

**Palët nënshkruese:**

**Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit**

**dhe**

**Kuvendi komunal: Lipjan**

Gjatë periudhës së realizimit të Grantit, e cila është e kufizuar brenda periudhës kohore prej 12 muajsh dhe të gjitha palët e lartpërmendura pajtohen si më poshtë:

### 1. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) pajtohet për:

- Dhënien e Grantit shkollor në shumë deri 15.000 \$, në pajtim me kushtet e caktuara në Doracakun e granteve për zhvillimin e shkollave.

Shkollat përfituese të Grantit në shumë deri 15.000 \$ në komunën e Lipjanit janë:

Emri i shkollës	Vendi	Lloji i shkollës	Buxheti
SHFMU "Emin Duraku"	Lipjan	Shkollë garuese	13.295,00 Euro
SHFMU "Ismail Luma"	Lipjan	Shkollë garuese	13.386,00 Euro
SHFMU "Vellezrit Frasheri "	Lipjan	Shkollë garuese	13.390,00 Euro
TOTALI I BUXHETIT			40.071,00 Euro

### 2. Ministria e Financave dhe Transfereve pajtohet për:

- Transferimin e fondeve në nën llogarinë e shkollës, të hapur në librin kryesor të thesarit për komunat përfituese të Granteve.

### 3. Drejtoria Komunale e Arsimit (përfituesi i Grantit) pajtohet për:

- Shfrytëzimin e fondeve të Grantit në përputhje me projekt propozimin për Grant, i miratuar nga Këshilli për Aprovimin e Granteve Shkollore (KAGSH)
- Ekzekutimin 100% të pagesave të shkollës pas dorëzimit dhe miratimit nga MASHTI të raporteve të kënaqshme financiare dhe të prokurimit lidhur me realizimin e aktiviteteve të Grantit për secilën kontratë të dhënë prej shkollës;  
Prokurimin e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve në pajtim me procedurat e prokurimit të dhëna në Doracakun e Granteve për Zhvillimin e Shkollave (përkatësisht, në Doracakun e Prokurimit). Këto udhëzime të prokurimit janë hartuar që t'u ndihmojnë shkollave dhe komunave të cilat përfitojnë GZhSh, që t'i kuptojnë drejtë dhe t'i zbatojnë metodat me të cilat duhet të blihen mallrat dhe shërbimet në kuadër të buxhetit të GZhSh-ve, i cili financohet prej mjeteve të huazuara nga IDA për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);
- Përfshihen procedurat e prokurimit publik të Republikës së Kosovës (Neni 3:5). Përfshihen: Ky ligj nuk zbatohet për aktivitetet e prokurimit që çojnë në dhënien e një kontrate publike, që bie në fushën e veprimit të një marrëveshje, që parashikon zbatimin e rregullave dhe/ose procedurave të tjera të prokurimit, ku (i) kjo marrëveshje e kushtëzon disponueshmërinë e financimit të kontratës në fjalë me zbatimin e rregullave dhe/ose procedurave të tjera, dhe (ii) marrëveshja është lidhur ndërmjet Qeverisë dhe një institucioni financiar ndërqeveritar, dypalësh, shumëpalësh ose ndërkombëtar.
- Mbajtjen e dokumentacionit të plotë dhe të hollësishëm për llogaridhënie lidhur me të gjitha shpenzimet e Grantit dhe të aktiviteteve të Grantit, duke i përmbushur kështu kërkesat e parashtruara nga MASHTI;
- Përgatitjen e raporteve të konsoliduara financiare, të monitorimit dhe raportit përfundimtar të Grantit për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në pajtim me

kërkesat e parashtruara në Doracakun e Granteve për Zhvillimin e Shkollave (përkatësisht në Doracakun e monitorimit);

- Realizimin e Grantit brenda periudhës së paraparë.

#### **4. Drejtori i shkollës (përfituesi i Grantit) pajtohet për:**

- Shfrytëzimin e fondeve të Grantit në pajtim me projekt propozimin e miratuar nga Këshilli për Aprovimin e Granteve Shkollore (KAGSH)
- Prokurimin e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve në pajtim me procedurat e prokurimit të cekura në Doracakun e Granteve për Zhvillimin e Shkollave (përkatësisht, në Doracakun e prokurimit);
- Mbajtjen e dokumentacionit të hollësishëm dhe të plotë për llogaridhënie lidhur me të gjitha shpenzimet nga fondi i Grantit dhe për aktivitetet e Grantit, duke i përmbushur kështu kërkesat e parashtruara të zyrës së DKA-së;
- Përgatitjen e raporteve financiare të monitorimit dhe raportit përfundimtar të Grantit për Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) në pajtim me kërkesat e parashtruara në Doracakun e Granteve për zhvillimin e shkollave (përkatësisht në Doracakun e monitorimit);
- Kërkimin e pëlqimit me shkrim prej MASHTI-t për shfrytëzimin e mjeteve të kursyera nga Granti i marrë në pajtim me planin e prokurimit të miratuar paraprakisht nga MASHTI;
- Organizimin e takimeve publike në fillim dhe gjatë procesit të realizimit (informim rreth progresit) dhe me të përfunduar të projektit, në mënyrë që t'i informojë të gjithë prindërit, mësimmshënësit dhe komunitetin lidhur me shumën e fondit të Grantit të fituar dhe me hollësitë e tjera mbi atë se si këto fonde janë shpenzuar dhe cilat janë shpenzimet e tyre aktuale;
- Realizimin e Granteve brenda periudhës së paraparë kohore.

#### **5. Ndërprerja e marrëveshjes:**

MASHTI ka të drejtë t'i shtyjë ose t'i ndërpresë aktivitetet e Grantit nëse performanca e realizimit nga Këshilli i shkollës nuk i përmbush kushtet e marrëveshjes për Grant bazuar në rekomandimin e DKA-së.

Vonesa ose dështimi në realizimin e Grantit të miratuar për shkak të gabimeve, pasaktësive ose pakujdesisë së Shkollës do të merret parasysh në vlerësimet e ardhshme të projekt propozimeve për Grante të parashtruara nga shkolla në fjalë.

#### **6. Rastet e paparashikuara:**

Nëse realizimi i Grantit të miratuar vonohet për shkak të ndonjë rasti të paparashikuar, atëherë nuk do të zbatohen ndalesat e parapara në pjesën "Ndërprerja e marrëveshjes" të cekura më lartë.

Mes tjerash, rastet e paparashikuara përfshijnë:

- Fatkeqësitë natyrore ose kushtet atmosferike që e bëjnë të pamundur realizimin e Grantit të miratuar;

- Grevat, trazirat, konfliktet ose situatat kaotike që e bëjnë të pamundur realizimin e grantit të miratuar;
- Situatat e tjera që nuk janë nën kontrollin e njerëzve, siç mund të konfirmohet nga MASHTI-i;

Nëse ndodhin rastet e paparashikuara, drejtori i shkollës duhet ta informojë DKA-në jo më larg se 14 ditë prej kohës kur ka ndodhë rasti i paparashikuar, si dhe duhet ta informojë DKA-në sa më parë që të mundet me rastin e normalizimit të situatës dhe se është filluar me realizimin e Grantit.

## 7. Sigurimi:

Përfituesi i Grantit është përgjegjës për marrjen e masave të duhura për sigurimin e mallrave dhe të punëve të financuara përmes Grantit.

## 8. Auditimi:

Në çdo kohë sa është në fuqi kjo marrëveshje auditori i brendshëm i MASHTI-it, Zyra Kombëtare e Auditorit dhe auditori i pavarur kanë autorizim t'i auditojnë të gjitha dokumentet e projektit. Përveç kësaj, MASHTI-i është përgjegjës për mbikëqyrjen, monitorimin dhe sigurohet që të gjitha shpenzimet në kuadër të projektit të bëhen në pajtim me marrëveshjen për Grant dhe projekt propozim.

Autorizim për auditimin e procedurave të prokurimit për grantet shkollore kanë: Njësia Koordinuese e Projektit, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe Banka Botërore. Nëse ka kërkesë për auditim të procedurave të prokurimit të granteve të shkollave, qoftë nga Zyra Kombëtare e Auditimit, ose nga Auditori i Komunës, atëherë auditimi duhet të bëhet sipas Doracakut të Granteve për Zhvillimin e Shkollave.

## 9. Të tjera:

Kjo marrëveshje për Grant konsiderohet e vlefshme dhe obliguese për palët nënshkruese pasi të jetë nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të MASHTI-it dhe Komunës përkatëse.

Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës - Lipjan



Agim Bërdyna

U.d. Sekretar i përgjithshëm /MASHTI

